



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES



15-21 DHJETOR JAVA E MBROJTJES





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

100 VITE FORCË DETARE

Forca Detare Shqiptare shënoi 100-vjetorin e krijimit në një ceremoni solemne, ku morën pjesë autoritetet më të larta të vendit. Në fjalën e tij, ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu theksoi rëndësinë strategjike të detit për sigurinë, sovranitetin dhe identitetin kombëtar, duke nënvizuar se për dekada me radhë Shqipëria e ka nënvlerësuar dimensionin e saj detar. Ai shtoi se sot Forca Detare është duke operuar krah NATO në misione reale si “Sea Guardian” dhe operacionet në Mesdhe.

★★★★★

mod.gov.al

JM



GJENERALMAJOR PETRIT ÇUNI, KOMANDANT I FT

Gjeneralmajor Petrit Çuni mori zyrtarisht detyrën e komandantit të Forcës Tokësore, në një ceremoni të posaçme. Pas dekretimit nga presidenti i Republikës, gjeneralmajor Petrit Çunit iu dorëzua komanda nga gjeneralmajor Ilir Xhebexhia, i cili u vlerësua për kontributin dhe drejtimin profesional gjatë mandatit të tij në krye të Forcës Tokësore.

★★★★★



MINISTRI VENUGU TAKIM ME TË RINJTË E PROGRAMIT TË PRAKTIKAVE

Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu zhvilloi një takim me të rinjtë pjesëmarrës në Programin e Praktikave në Ministrinë e Mbrojtjes, ku theksoi se mbrojtja e vendit ndërtohet mbi njerëzit, dijen dhe vizionin, jo vetëm mbi kapacitete teknike. Ai vlerësoi rolin e të rinjve në sjelljen e ideve të reja dhe këndvështrimeve moderne, si dhe diversitetin profesional të praktikantëve, përfshirë ata me formim brenda dhe jashtë vendit.

★★★★★



STËTVITJA “GOLDEN SWORD 25”

Forcat e Armatosura të Shqipërisë morën pjesë në stërvitjen ndërkombëtare “Golden Sword 25”, ku Batalioni i Këmbësorisë së Lehtë demonstroi profesionalizëm dhe disiplinë përkrah aleatëve dhe partnerëve ndërkombëtarë.

JM

★★★★★



URA E QAFËZESIT KTHEHET NË FUNKSIONALE

Ura e Qafëzesit në Kolonjë është kthyer funksionale në kohë rekord falë angazhimit të Batalionit Xhenio. Kjo ndërhyrje ka rikthyer aksesin rrugor për banorët e 12 fshatrave të zonës, duke garantuar lidhjen dhe lëvizjen normale për komunitetin lokal.

JM



EOD AKSION PËR LARGIMIN E MUNICIONEVE

Specialistët EOD të Batalionit të Xhenios, realizuan disa operacionet për largimin dhe asgjësimin e municioneve të identifikuara në bashkitë Pogradec, Elbasan dhe Devoll. Operacionet janë ndërmarrë në përputhje me procedurat e parashikuara në manualet EOD, me qëllim garantimin e sigurisë publike dhe eliminimin e çdo rreziku për qytetarët dhe mjedisin.

★★★★★



PËRMBYLLET STËRVITJA “ORF COMMAND POS EX”

Është përmbyllur me sukses stërvitja e komandës së shtabit dhe nënrepartëve të batalionit shumëkombësh të Rezervës Operacionale, “ORF Command POS EX”, në kuadër të përgatitjes për misionet KFOR dhe ALTHEA. Stërvitja bëri bashkë efektiva nga Bullgaria, Greqia, Rumania dhe Shqipëria, të përfaqësuar nga personeli i shtabit të batalionit, i cili duke nisur nga data 1 janar 2026 do të marrë komandimin e kësaj njësie shumëkombëshe.

★★★★★



“DITË E HAPUR” NË KOMANDËN MBËSHTETËSE

Në komandën mbështetëse u zhvillua “Dita e Hapur” në një aktivitet i cili kishte për qëllim informimin dhe afrimin e qytetarëve, të rinjve dhe vizitorëve me misionin, rolin dhe aktivitetet e kësaj komande. Gjatë kësaj dite, pjesëmarrësit patën mundësinë të njihen nga afër me strukturat, pajisjet, si dhe me kapacitetet mbështetëse që kontribuojnë në funksionimin e forcave.

★★★★★